

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË " Airway Health" SH.P.K.

Sot, me datë 04/11/2025

Z. Edlir Dume, shtetas Shqiptar, lindur më 01/08/1986 në Tirane, Shqiperi, mbajtëse i Pasaportes me nr BB3795130 madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**Airway Health**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1 EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është Airway Health Sh.p.k.

NENI 2 SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr Kristaq Mema, Pallati 2. Shkalla 4 apt 5. Tirane , Albania, 1001 Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4 OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Ofrimi i shërbimeve dentare; importimi dhe tregtimi i aparaturave dentare dhe mjeksore; zhvillimi dhe implementimi i programeve kompjuterike, përfshirë software mjeksor dhe dentar; ofrimi i shërbimeve të faturimit dhe kodimit (billing and coding) në fushën e mjeksisë dhe stomatologjisë.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 1.000.000 Lek (Njemilion leke) dhe përbëhet nga 1 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

Z. Edlir Dume zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1,000,000 Lek dhe 1,000,000 Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z Edlir Dume** i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar **Z. Edlir Dume**, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. I60801058E, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

Z. Edlir Dume